

Ligjëratë nga lënda:

## **Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci Moderne**

Përmbledhje ligjërate V

### **Konflikti ndërkombëtar**

- Lufta dhe mjetet tjera të dhunës ndërkombëtare përdoren si mjete ndikimi në përpjekje për të përmirësuar kushtet e zgjidhjes së konflikteve.
- Lidhur me kohën se kur përdoren këto forma ndikimi, janë ofruar shumë teori që shërbejnë si shpjegime të përgjithëshme, çka ka të bëjë me shkaqet e lutërave. Në çdo nivel të analizës janë propozuar teori kontradiktore dhe, me përjashtim të dy prej tyre, asnjëra nuk ka mbështetje të forte në fakte. Kështu, shkencëtarët politik nuk mund të parashikojnë në mënyrë të besueshme shpërthimin e luftës.
- Të dy përjashtimet janë: njëri sipas të cilit pothuajse nuk ekzistojnë shoqëri në të cilat lufta dhe dhuna ndërmjet grupeve, e përdorur si mjet ndikimi nuk njihet; dhe dyta sipas të cilit shtetet demokratike nuk bëjnë pothuaj kurrë luftëra kundër demokracive të tjera.
- Shtetet hyjnë në konflikt me njëri-tjetrin dhe me aktorët joshitetëror për një shumëllojshmëri arsyesh. Konfliktet do të ekzistojnë gjithnjë ndërmjet aktorëve ndërkombëtarë.
- Grindjet territorial janë ndër konfliktet ndërkombëtare më serioze, meqenëse shtetet e vlerësojnë shumë tërësinë tokësore. Megjithatë, me pak përjashtime, pothuaj të gjithë kufijtë e botës tani janë të përcaktuar qartë e të njohur ndërkombëtarisht.
- Konfliktet për vendosjen e kontrollit mbi shtete të tëra (nëpërmjet vendosjes së kontrollit mbi qeveritë) gjithashtu janë serioze dhe krahasimisht të mundëshme, që të qojnë drejtë përdorimit të forcës.
- Konfliktet ekonomike qojnë drejtë dhunës shumë më pak, sepse përfitimet positive prej veprimtarive ekonomike janë nxitje më të rëndësishme se sa kërcënimet negative të dhunës. Megjithatë, disa lloje të veçanta të konfliktit ekonomik kanë ndikime të veçanta mbi sigurimin kombëtar.
- Trafikimi i drogës krijon disa lloj konfliktesh të cilat tërheqin brenda tyre si aktorë shtetërorë dhe joshitetërorë.
- Konfliktet etnike që lidhen me grindjet territorial janë shumë të vështira për t'u zgjidhur përshkak të njëanshmërive psikologjike. Është e vështirë të shpjegohet se përse besnikëritë e njerëzve ndonjëherë i përkasin grupit etnik e here të tjera shtetit shumëkombësh.
- Lëvizjet fetare fundamentalist përbëjnë një sfidë të madhe për rregullat e sistemit ndërkombëtar në përgjithësi dhe sovranitetin shtetëror në veçanti. Fundamentalizmi islamik është veçanërisht i fortë, sepse ai prekë ndjenjat antiperëndimore që ekzistojnë në Lindjen e Mesme.
- Në marrëdhëniet ndërkombëtare ideologjitë nuk kanë shumë rëndësi, me përjashtim të demokracisë si ideologji. Udhëheqësit e shteteve mund t'i përdorin ideologjitë për të përligjur çfardollosje veprimesh të cilat janë në interes të tyre.

- Kur në marrëdhëniet ndërkombëtare përdoren mjete të dhunshme për ndikim, atëherë prej kësaj vijnë një larmi llojesh të luftës. Këto ndryshojnë shumë nga madhësia e karakteri, prej luftërave guerile e sulmeve deri te lufta hegjemoniste për udhëheqje të sistemit ndërkombëtar. Në këtë tërësi përdorimesh të dhunës, përkufizimi i saktë i luftës është i pasigurtë.
- Ashtu si mjetet e tjera të ndikimit, edhe terrorizmi përdoret për të krijuar përparësi në rrethanat ndërkombëtare të përpjekjeve për marrëveshje. Terrorizmi është veprues nëqoftëse ai ul moralin e një popullsie e arrinë të tërheq vëmendjen e medias për çështjen për të cilën lufton.